



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPALLJE NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

Lloji i diplomës “Gazetari/marketing/shkenca komunikimi/shkenca politike/shkenca shoqërore”

niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë së ulët drejtuese:

- 1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Përmbajtjes, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Analizës - Kategoria e pagës III-1

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë ku mund të marrin pjesë për konkurim edhe kandidatët nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje. Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJE PARALELE: 23 Prill 2026

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË/PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL: 30 Prill 2026

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Respekton dispozitat ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi regjistrimin e tërësisë së programeve të transmetuara nga oshma-të;
- Mbikqyr dhe koordinon punën në Sektor, për të realizuar monitorimin e programeve informative të OSHMA–ve publike dhe private apo përmbajtjet e kërkuara dhe raporton evidentimin e rasteve jo etike dhe në kundërshtim me Kodin e Transmetimit.
- Mbikqyr dhe koordinon punën në Sektor, për monitorimin e volumit të reklamave, në zbatim të kërkesave të ligjit për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë.
- Mbikqyr dhe koordinon punën në Sektor, për evidentimin e rasteve të shkeljeve të Ligjit 97/2013 dhe Kodit të Transmetimit në përmbajtjet që monitorohen.

I- Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

I.1 - Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për “Gazetari/marketing/shkenca komunikimi/shkenca politike/shoqërore”.
- Të ketë njohuri të thella të gjuhës angleze;
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në nivel të ulët drejtues.
- Të ketë përvojë pune në fushën e komunikimit.
- Të ketë aftësi për të ofruar drejtim profesional, për të planifikuar, koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dipozicion.
- Aftësi shumë të mira komunikimi prezantimi dhe analitike.

I.2 - Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njesisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit në punë;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 23 Prill 2026.

I.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 23 Prill 2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Kodi i Transmetimit;
- Kodin e Procedurave Administrative.
- Ligjin nr. Nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike.
- Vendim Nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

I.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht (20 pikë) përvojë pune, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Legjislacionin e përmendur në pikën I.4;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

I.6- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II – Ngritja në detyrë dhe pranimi nga jashtë shërbimit civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin

nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë apo pranimit nga jashtë për kategorinë e ulët drejtuese.

II.1-Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Për aplikimet e ngritjes në detyrë të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për “Gazetari/marketing/shkenca komunikimi/shkenca politike/shoqërore”. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- Të kenë mbi 3 vite përvojë pune në pozicione të kategorisë ekzekutive në fushën përkatëse;
- Të ketë mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse në profesion (për nëpunësin jashtë shërbimit civil)
- Të ketë aftësi për të ofruar drejtim profesional, për të planifikuar, koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dispozicion.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;

II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 30 Prill 2026, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e

kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Kodi i Transmetimit;
- Kodin e Procedurave Administrative.
- Ligjin nr. Nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike.
- Vendim Nr. 874, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

II.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
2. Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë

II.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Autoritetit dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë.